

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Trump paralajmëron Zelenskyn: Ndaloni sulmet ndaj naftës ruse, po dëmtoni ekonominë botërore
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/trump-paralajmeron-zelenskyn-ndaloni-et-ndaj-naftes-ruse-po-demtoni-eko-i585874
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHË


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 18:11:38 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	13 shtator 2026, 18:10:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	b2faf45536795978d223380da9681ebf5f88e8cd5bac802702cc4059df473a14
TEKSTI	71126b71eb7ac66f9cdbf777097eaf572badfe3c9d74d9ba6702430896c65e06
PAMJA	5880335e55d6e09b8e904968370f07dc68f07bd8cefc52c7e5e7369f32fcb081

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	95d0f92734f95362dedc8e72f8a3ad022efd1452a82a232c1c9af38859fa24e0
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	af2eff8ceb96ddd2f94c87aa44001511ffb7ade52559e069c66da2a10eed6fb8
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/95d0f92734f95362dedc8e72f8a3ad022efd1452a82a232c1c9af38859fa24e0>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)

English

ie Trump paralajmëron Zelenskyn: Ndaloni sulmet ndaj naftës ruse, po dëmtoni ekonominë botëroreGara e Ai-se po tremb edhe vete krijuesit e sajTensionet me Trump sh fundit

Trump paralajmëron Zelenskyn: Ndaloni sulmet ndaj naftës ruse, po dëmtoni ekonominë botërore



13 Shtator 2026, 20:10Bota TEMA



Presidenti amerikan, Donald Trump, ka lëshuar paralajmërime të ashpra ndaj Presidentit ukrainas, Volodymyr Zelensky, lidhur me taktikat e tij ushtarake dhe sulmet ndaj objekteve ruse të karburantit.

Gjatë një prononcimi të dielën nga klubi i tij i golfit në Doonbeg të Irlandës, Trump u shpreh se Zelenskyy po dëmton ekonominë botërore përmes këtyre veprimeve. Sipas tij, mungesa e karburantit dhe naftës në tregjet globale po shkaktohet nga konflikti Rusi-Ukrainë dhe jo nga situata në Lindjen e Mesme, ndaj i bëri thirrje Kievit që të ndalojë shkatërrimin e karburantit dizel në Rusi.

"Zelensky duhet të bëjë një gjë, të ndalojë shkatërrimin e karburantit dizel në Rusi. Ai po krijon mungesë të naftës. Kjo nuk po ndodh për shkak të Lindjes së Mesme, por për shkak të asaj që po ndodh midis Rusisë dhe Ukrainës", u tha presidenti amerikan gazetarëve, duke iu referuar udhëheqësit ukrainas.

"Le të ndjekë qëllimet e tij, por jo naftën, sepse ajo shkakton mungesë naftë dhe dëmton botën", shtoi Trump.

Për muaj me radhë, Ukraina ka ndërmarrë sulme me rreze të gjatë veprimi dhe me dronë ndaj industrisë ruse të naftës dhe gazit, të cilën Kievit e konsideron si burimin kryesor financiar që nxit dhe ushqen pushtimin rus. Kjo fushatë ka sjellë kufizime në shpërndarjen e brendshme të karburantit në Rusi dhe ka përfshirë shënjestrimin e shitësve kryesorë online, duke e afruar luftën gjithnjë e më pranë popullsisë civile. Ndërkohë, si kundërpërgjigje, Rusia ka intensifikuar fushatën e saj ajrore duke përdorur raketa balistike dhe dronë, me synim kryesor shkatërrimin e rrjetit elektrik të Ukrainës përpara dimrit.

Në frontin diplomatik, situata mbetet e ndërlikuar, megjithëse ka sinjale për dialog. Zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov, deklaroi të dielën se Moska është e hapur për të rifilluar bisedimet e paqes gjatë vjeshtës, duke përfshirë Rusinë, Ukrainën dhe Shtetet e Bashkuara, dhe se muaji tetor mbetet një mundësi e hapur. Kjo deklaratë vjen pas vizitave që të dërguarve amerikanë, Jared Kushner dhe Steve Witkoff, zhvilluan së fundmi në Moskë dhe Kiev. Megjithatë, pavarësisht përpjekjeve diplomatike, kërkesat themelore të të dyja palëve vazhdojnë të mbeten të papajtueshme, veçanërisht për sa i takon çështjes së lëshimeve territoriale.

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Tensionet me Trump shtyjnë Kanadanë drejt Europës, Carney shqyrton statusin e “anëtarit të asociuar” me BE-në](#)

19:50 Bota

[Goditet rrjeti i drogës në Turqi, sekuestrohen 350 kg kokainë të ardhur me anije nga Brazili! 9 persona në pranga](#)

19:41 Bota

Policia turke bastis bare dhe shtëpi të aktivistëve të komunitetit LGBTQ+, arrestohen 47 persona

19:30 Bota

Një person futet në shtëpinë e Kamala Harris në Kaliforni, ndërhyjnë personeli i sigurisë

19:20 Bota

123456789

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.